

## RRJEDHA E PUNËS 1 – Korniza e politikave

### Veprimi 2: përshkruani llojet kryesore të dhunës ndërpersonale

#### Dhuna ndërpersonale

Përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i pushtetit, nga një individ ose një grup i vogël individësh, kundër vetes, apo kundër një personi tjetër ose kundër një grupi ose komuniteti, që rezultojn ose ka një gjasë të lartë të rezultojë në lëndim, vdekje, dëm psikologjik, keqzhvillim ose privim. Mund të ndodhë on-line, të kryhet nga aktorë të ndryshëm dhe të marrë forma të ndryshme.

#### Abuzimi/keqtrajtimi i fëmijëve

Abuzimi ose keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimit seksual, neglizhencës ose trajtimit neglizhent ose shfrytëzimit komercial ose të çdo lloji tjetër, që rezultojn në dëm real ose potencial të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.

#### Dhunë seksuale (përfshin ngacmimin seksual)

Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose ngacmime seksuale të padëshiruara, ose akte për trafikim, ose të drejtuara ndryshe kundër seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën, në çdo mjedis apo vend. Format e ndryshme të dhunës seksuale mund të ndodhin si në internet, on-line, ashtu edhe personalisht.

#### Dhunë fizike

Dhuna fizike është një akt që përpiket të shkaktojë ose rezultojn në dhimbje dhe/ose lëndime fizike, dhe përfshin rrahjen, djegien, shqelmimin, grushtimin, kafshimin, gjymtimin ose vrasjen, ose përdorimin e objekteve ose armëve.

#### Dhuna psikologjike

Dhuna psikologjike (abuzimi) përfshin përdorimin e rregullt dhe të qëllimshëm të një sërë fjalësh dhe veprimesh jofizike me qëllim manipulimin, lëndimin, dobësimin ose frikësimin e një personi mendërisht dhe emocionalisht; dhe/ose shtrembërimin, ngatërrimin ose ndikimin e mendimeve dhe veprimeve të një personi brenda jetës së tij të përditshme, duke ndryshuar ndjenjën e tij për veten dhe duke dëmtuar mirëqenien e tij. Në sport, ajo mund të marrë gjithashtu formën e veprimeve jofizike që shkaktojnë dëm fizik ose psikologjik tek atleti. Dhuna psikologjike mund të ndodhë si në internet, on-line, ashtu edhe personalisht dhe në forma të ndryshme.

## Neglizhenca

Neglizhenca përfshin dështimin për t'i siguruar një atleti një standard të përshtatshëm të ushqyerjes, kujdesit mjekësor, veshjes, strehimit ose mbikëqyrjes deri në masën që shëndeti ose zhvillimi i atletit dëmtohet ndjeshëm ose vihet në rrezik serioz. Një atlet neglizhohet nëse lihet pa kujdes për periudha të gjata kohore ose braktiset.

## Ngacmimi

Çdo sjellje poshtëruese, degraduese, abuzive ose e rrezikshme e një shoku skuadre të të vjetër ndaj një atleti të ri, e cila nuk kontribuon në zhvillimin pozitiv të atletit, por kërkohet që të pranohet si pjesë e një ekipi, pavarësisht nga gatishmëria e atletit të ri për të marrë pjesë. Ngacmimi mund të përfshijë edhe dhunë psikologjike, fizike ose seksuale.

## Bullizimi

Bullizimi mund të përkufizohet si sjellje e qëllimshme dhe agresive që ndodh në mënyrë të përsëritur kundër një viktime, ku ekziston një çekuilibër i vërtetë ose i perceptuar i fuqisë, dhe ku viktima ndihet e cenueshme dhe e pafuqishme për të mbrojtur veten. Sjellja e padëshiruar është e dhimbshme: mund të jetë fizike, duke përfshirë goditjen, shqelminim dhe shkatërrimin e pronës; verbale, siç janë ngacmimi, fyerja dhe kërcënim; ose relacionale, përmes përhapjes së thashethemeve.

## Grooming (Manipulim)

Përdorimi i një sërë teknikash manipuluese dhe kontrolluese ndaj një atleti të cenueshëm; në një sërë mjedisesh ndërpersonale dhe shoqërore, për të krijuar besim ose për të normalizuar sjelljen seksualisht të dëmshme, me qëllimin e përgjithshëm të lehtësimit të shfrytëzimit dhe/ose ndalimit të ekspozimit. Mund të ndodhë në internet ose personalisht.

## KËSHILLË:

Kërkoni më shumë informacion: [Deklarata e konsensusit të IOC-së: dhuna ndërpersonale dhe mbrojtja e sporteve.](#)